



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë 03.12.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 02.12.2020, të parashtruar nga Operatori Ekonomik, "Wood company" SHPK Marevc Lagjeja Vitija lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Furnizimi me pelet për shkollat, QKMF-në dhe DKRS-në-Kontratë kornizë"** me Nr. të Prok 613 020 125 111

V E N D I M

Aprovohet pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim, e parashtruar nga Wood company" SHPK Marevc Lagjeja Vitija pjesëmarrës në tenderin me titull **"Furnizimi me pelet për shkollat, QKMF-në dhe DKRS-në-Kontratë kornizë"** me Nr. të Prok 613 020 125 111

Anulohe Vendimi i AK për dhënien e kontratës të publikuar me datë: 27/11/2020 dhe kthehet lënda në Rivlersim;

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik Wood company" SHPK Marevc Lagjeja Vitija, me datë 02.12.2020 ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit **Furnizimi me pelet për shkollat, QKMF-në dhe DKRS-në-Kontratë kornizë"** me Nr. të Prok 613 020 125 111

ku ne kete aktivitet AK ka shpallur fitues Basri Sopjani" B.I , **për shpërblim me kontratë**, të datës 27.11.2020 te publikuar ne platformen elektronike e-prokurimi.

Operatori Ekonomik Wood company" SHPK Marevc Lagjeja Vitija,, me datë. 02.12.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit **Furnizimi me pelet për shkollat, QKMF-në dhe DKRS-në-Kontratë kornizë** Autoriteti Kontraktues, me datë 03.12.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Kerkesa e OE Wood company" SHPK ka te bej me at se AK nuke ka kerkuar sqarim sa i perket Listes se kontratave dhe deshmive (kontratat, procesverbalet etj)

Sqarim:

AK ne njoftimin per kontrat ka kerkuar:

Dëshmia 1 Një listë te kontratave të realizuara ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose procesverbalet për kryerje të furnizimeve.


Ju keni paraqitur Listen e kontratave e cila nuk i ka përmbushë kriteret që i ka kërkuar Autoriteti kontraktues, siç janë: titullin e kontratës (qe do te dihej se me çfarë artikulli i keni furnizuar) datën e fillimit dhe përfundimit të asaj kontrate dhe elementet e tjera që i keni paraqit në listë, për këtë obligohet Autoriteti Kontraktues që të kërkojë sqarim(dëshmi) kontratat me përfituesit që i keni paraqitur në listë dhe referenca ose procesverbalet për dëshmi se i keni përfunduar me sukses këto kontrata.

AK, konsideron se tenderi juaj është vlersuar me kujdes dhe ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP

Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.


Drejtör i Prokurimit